REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

RAPORTI 6 MUJOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E MJEDISIT, PËR VITIN 2026

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhja ekzekutive (*pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë*)

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2026, procesi i konsultimit publik është realizuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" për 23 projekt akte, 6 prej të cilave (2 projektligje dhe 4 projektvendime) janë miratuar në Këshillin e Ministrave.

Në zbatim të urdhrit nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik", konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projekt vendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun.

Ministria e Mjedisit ka publikuar pas procesit të konsultimit publik, edhe raportet përkatëse individuale për rezultatet e konsultimit publik për secilin projektakt të publikuar në regjistër, duke përmbushur parimin e reagueshmërisë dhe llogaridhënies së këtij procesi.

Metodat për konsultimin e këtyre akteve janë përzgjedhur duke marrë parasysh kompleksitetin e akteve dhe implikimet që krijojnë tek qytetarët dhe grupet e interesit.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se për 6 mujorin e vitin 2026 ka patur komente apo rekomandime për disa akte të konsultuara në këtë platformë. Gjithashtu, komentet kanë ardhur me postë elektronike nga grupet e interesit.

Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar. Format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar me qëllim hartimin e projektakteve sa më gjithëpërfshirëse, të pranueshme dhe që reflektojnë interesin publik.

Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

2. *Analiza e konsultimeve të kryera*

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i akteve të Ministrisë së Mjedisit që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik dhe që janë miratuar në Këshillin e Ministrave, gjatë 6 mujorit 2026 është 6 (gjashtë), konkretisht:

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 29/2024 "Për burimet ujore";
2. "Për miratimin e Programit të Parandalimit të Mbetjeve";
3. "Për miratimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036";
4. "Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore";
5. "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores"për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO2";
6. "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve", i ndryshuar.

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje me ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Në zbatim të nenit 1, të ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore.

Në zbatim të urdhrit nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik", konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun, pra jo vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t'iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1, të ligjit të sipërcituar.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Projekt aktet e konsultuara dhe të miratuara brenda 6 mujorit të vitit 2026, me propozim të MMj-së, janë 6, 2 (dy) projektligje dhe 4 (katër) projektvendime.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

6 (gjashtë) projektakte kanë qenë objekt konsultimi dhe janë konsultuar në masën 100% nëpërmjet metodave të ndryshme konsultative.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Për 6 mujorin e parë të vitit 2026, rezulton që janë konsultuar 2 (dy) projektligje me raport VNR-je, konkretisht:

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 29/2024 "Për burimet ujore";
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve" i ndryshuar.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Ministria e Mjedisit ka parashikuar në Programin Analitik 2026, miratimin e 36 akteve, ku vetem për 1 projektakt aplikohet përjashtimi i parashikuar në shkronjën "c", të nenit 4, të ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e akteve që iu nënshtruan konsultimit publik janë: 2 (dy) projektligje dhe 4 (katër) projektvendime.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me një vit më parë, lidhur me kriteret apo përjashtimet nga konsultimet publike, rezulton se numri i akteve të përjashtuara nga ky proces është më i ulët. MMj ka vijuar të zbatojë standardet e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar zhvillimin e konsultimeve në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

2.2Metodat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Të gjitha projektaktet e miratuara për periudhën Janar-Qershor 2026 janë konsultuar nëpërmjet metodave të ndryshme të konsultimit:

Metodat e përzgjedhura për konsultim publik ishin:

- Regjistri Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik;
- posta elektronike,
- konsultim e këshillim gjatë hartimit të projekt aktit;
- tryeza të konsultimit publik pas përgatitjes së projekt aktit;

Grafik 1: Metodat e përdorura të konsultimit publik



2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte nëpërmjet postës elektronike si dhe regjistri i konsultimit publik (RENJK), nga organizatat e shoqërisë civile të cilët zgjedhin që komentet e tyre t'i dërgojnë në adresën e koordinatorit të konsultimit publik apo personit tjetër të kontaktit, që është sipas rastit, specialisti përgjegjës për hartimin e projektaktit.

Gjithashtu edhe nga zhvillimi i dëgjesave publike janë gjeneruar një numër i konsiderueshëm komentesh.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Institucioni nuk ka zhvilluar konsultime paraprake, në fazat e hershme të hartimit të project akteve.

2.3 ***Kohëzgjatja e konsultimeve***

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për të gjitha projektaktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit public dhe që janë miratuar në 6 mujorin e parë të vitit 2026 , nëpërmjet publikimit në RENJK, është respektuar afati ligjor prej 20 ditë pune.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë minimalisht një muaj, pra 30 ditë kalendarike, referuar afatit të publikimit në RENJK, të secilit projektakt.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Edhe për këtë periudhë, konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e miratuara gjatë 6 mujorit të vitit 2026 u realizua në përputhje me parashikimin ligjor lidhur me respektimin e afatit prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit.

2.4 ***Palët e interesuara të përfshira***

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Të gjitha aktet e konsultuara dhe të miratuar janë hartuar nga strukturat e Ministrisë së Mjedisit.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës paraqitet më poshtë:

1.Giz
2. Shoqëria Civile
3. Ekspertë mjedisi
4. Media

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime te hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

5 (pesë) palë të interesuara morën pjesë në procesin e konsultimit të projekt-akteve.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Gjatë periudhës së konsultimit publik për aktet e miratuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2026, kanë dhenë komente vetëm ekspertë mjedisi.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësohet se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procesin e konsultimit, të organizuar nga ministria. Gjithashtu, një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i faqes së Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projekt aktet e publikuara në të.

2.5 ***Rekomandimet dhe komentet e marra***

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Për projektaktet e miratuara për 6-mujorin e vitit 2026, numri i rekomandimeve dhe komenteve është si vijon:

1. "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 29/2024 "Për burimet ujore"; 0 komente;
2. "Për miratimin e Programit të Parandalimit të Mbetjeve"; 4 komente, 4 refuzuar;
3. "Për miratimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036"; 0 komente
4. "Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore", 7 komente, 3 pranuar, 1 pranuar pjesërisht, 3 refuzuar.
5. "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores"për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO2", 0 komente.
6. "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve" i ndryshuar, 0 komente.

Gjithsej janë administruar 11 komente.

2.5.2 prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan

Për 6 (gjashtë) projekt aktet e konsultuara dhe të miratuara për 6 mujorin e parë të vitit 2026, numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra ishte 11, nga këto u pranuan plotësisht 3 (tre), 1 (një) u pranua pjesërisht, ndërsa 7 u refuzuan.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme, duke theksuar një përmirësim, krahasuar me vitet e kaluara.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nuk ka patur ndryshim të raportit të vlerësimit të ndikimit rregullator si pasojë e procesit të konsultimit.

2.6 ***Raportet mbi rezultatet e konsultimit***

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për të gjitha aktet e publikuara në RENJK, për të cilat afati i konsultimit është mbyllur dhe është bërë vlerësimi i komenteve nga strukturat teknike, institucioni ka publikuar raportet individuale të konsultimit.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka patur raste të mospublikimit.

*2.7***Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik *(****Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)***

Indeksi i performancës për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë e Mjedisit është 8, për secilin nga projektaktet e konsultuara dhe të miratuara

3. **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore të konsultimit publik vijojnë të lidhen edhe këtë vit, kryesisht, me nevojën për një përfshirje më të gjerë dhe më aktive të publikut në këtë proces. Ende nuk evidentohet në nivelin e dëshiruar një kulturë e konsoliduar e angazhimit në proceset e hartimit të politikave, pavarësisht përmirësimeve të vërejtura gjatë periudhës së fundit.
Në periudhën në vijim, me qëllim rritjen e cilësisë së procesit të konsultimit publik, Ministria do të vijojë të ndërmarrë masa për forcimin e ndërgjegjësimit të publikut dhe rritjen e transparencës së këtij procesi, përmes informimit më aktiv dhe përdorimit më efektiv të kanaleve të komunikimit dhe teknologjive të informacionit.